



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
KOMISIONI I AKREDITIMIT TË AKTIVITETEVE TË ZHVILLIMIT PROFESIONAL**

Nr.566 prot.

Tiranë, më 20.05.2026

**SHPLLJA E INTERESIT**

**PËR APLIKIM PËR AKREDITIMIN E MODULEVE TË TRAJNIMIT PËR  
PUNONJËSIT ARSIMORË TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të VKM-së nr. 98, datë 27.02.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” (ASCAP); të urdhrin nr. 32 të MAS-it, datë 28.01.2020, “Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”; të udhëzimit të MAS-it nr. 16, datë 22.07.2024, “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”; të urdhrin nr. 157 të ASCAP-it, datë 23.09.2024, “Për miratimin e udhëzuesit për procedurat dhe kriteret e akreditimit dhe të njohjes së aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional për punonjësit arsimorë”; si dhe të urdhrin nr. 172 të ASCAP-it, datë 30.10.2024, “Për ngritjen e Komisionit të Akreditimit të Aktiviteteve të Zhvillimit Profesional”,

Njoftohen ofruesit e aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional (ZHVP-së), të cilët janë të interesuar për të organizuar trajnime me punonjësit arsimorë të sistemit parauniversitar, se mund të aplikojnë për akreditimin e moduleve të trajnimit. Ofruesi i aktiviteteve të ZHVP-së ka të drejtë të aplikojë për akreditim deri në 10 (dhjetë) module trajnimi, për një periudhë vlefshmërie 4-vjeçare.

**1. APLIKIMI NGA OFRUESIT E AKTIVITETEVE TË ZHVP-SË PËR TË AKREDITUAR  
MODULE TRAJNIMI REALIZOHET SI MË POSHTË:**

**Faza 1**

- a) Ofruesi i aktiviteteve të ZHVP-së dorëzon, me email dhe me postë, kërkesën e aplikimit të shoqëruar me dokumentacionin përkatës sipas shtojcave 3 dhe 4 të *Udhëzuesit për procedurat dhe kriteret e akreditimit dhe të njohjes së aktiviteteve të ZHVP-së për punonjësit arsimorë*, bashkëlidhur këtij njoftimi.

- b) Komisioni i Akreditimit të Aktiviteteve të Zhvillimit Profesional vlerëson kërkesën e aplikimit dhe njofton me email ofruesit e aktiviteteve të ZHVP-së për miratimin ose jo të temave të moduleve të trajnimit.

## **Faza 2**

- a) Ofruesit, pas marrjes së njoftimit me email nga KAAZHP për miratimin e temave të moduleve të trajnimit, ngarkojnë për vlerësim dhe miratim modulet e trajnimit (sipas shtojcës 5), në faqen e RASH-it: <https://trajtime.arsimi.rash.al> dhe CV-të e trajnerit/ëve për çdo modul sipas modelit EUROPASS.
- b) Komisioni i Akreditimit të Aktiviteteve të Zhvillimit Profesional vlerëson modulet e trajnimit dhe njofton ofruesit e aktiviteteve të ZHVP-së për akreditimin ose jo të moduleve të trajnimit.

*Shënim. Ofruesit e aktiviteteve të ZHVP-së që aplikojnë, mbajnë përgjegjësi për plotësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të kërkuar sipas formateve bashkëlidhur.*

## **2. DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT PËRMBAN:**

- a) Formatin e aplikimit të plotësuar sipas shtojcës 3. Bashkëlidhur shtojcës 3 dorëzohet edhe dokumentacioni juridik dhe dhe CV-të e trajnerit/ëve për çdo modul sipas modelit EUROPASS.
- b) Listën përmbledhëse të moduleve të trajnimit me të dhënat përkatëse (shtojca 4).
- c) Ofruesi i aktiviteteve të ZHVP-së dorëzon aplikimin:
- me postë në adresën postare të ASCAP-it: *Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, rruga “Naim Frashëri” nr. 37”, Tiranë.*
  - me email në adresën [katsekretariati@gmail.com](mailto:katsekretariati@gmail.com).

## **3. AFATET E APLIKIMIT, SIPAS OFRUESVE TË AKTIVITETEVE, JANË SI MË POSHTË:**

### **Faza 1**

- a) Kanë të drejtë të aplikojnë me shtojcën 3 dhe 4 nga data 25 maj 2026 e në vijim:
- ofruesit e aktiviteteve të ZHVP-së të cilët janë të përfshirë në zbatimin e Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve;
  - ofruesit e aktiviteteve të ZHVP-së që kanë marrëveshje bashkëpunimi me ministrinë përgjegjëse për arsimin ose me institucionet e saj të varësisë;
  - ofruesit e aktiviteteve të ZHVP-së që ofrojnë trajnime pa pagesë (falas) për punonjësit arsimorë.

b) Kanë të drejtë të aplikojnë me shtojcën 3 dhe 4 gjatë periudhës 25 maj 2026 – 1 qershor 2026 ofruesit e aktiviteteve të ZHVP-së që ofrojnë trajnime me pagesë për punonjësit arsimorë, vetëm për tema specifike që nuk përfshihen në Programin Kombëtar të Zhvillimit Profesional të punonjësve arsimorë (PKZHPM) 2026-2028, në strategjitë apo planet që mbulohen nga Ministria e Arsimit (MA) dhe institucionet e saj të varësisë.

*Shënim. Kujtojmë se ofruesit e aktiviteteve të ZHVP-së kanë të drejtë të aplikojnë për akreditimin e deri në 10 (dhjetë) moduleve të trajnimit për një periudhë 4-vjeçare.*

## **Faza 2**

c) Afati i aplikimit për akreditimin e moduleve të trajnimit me shtojcën 5 (referohu më lart pika 1,c) për temat e miratuara nga KAAZHP është *data 22 qershor 2026 – 30 qershor 2026* në faqen e RASH-it: <https://trajnime.arsimi.rash.al>.

## **4. TEMATIKAT E TRAJNIMIT TË MBULUARA NGA PKZHPM, MA DHE INSTITUCIONET E SAJ TË VARËSISË.**

Në tabelën më poshtë paraqiten tematikat e përfshira në Programin Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve (PKZHPM) 2026–2028, si dhe tematikat që mbulohen në kuadër të strategjive dhe planeve të Ministrisë së Arsimit dhe institucioneve të saj të varësisë.

Të gjithë ofruesit e aktiviteteve të zhvillimit profesional mund të aplikojnë për tema specifike që nuk janë të përfshira në këtë tabelë.

<b>Tematikat kryesore të mbuluara nga PKZHPM-ja, MA-ja dhe institucionet e saj të varësisë, sipas fushave përkatëse</b>
<b>Fusha: KMV (Kurrikula, Metodologjia dhe Vlerësimi)</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Përditësimet kurrikulare sipas profileve lëndore dhe trajtimi i përmbajtjes shkencore sipas fushave/lëndëve.</li><li>- Zhvillimi holistik i fëmijëve 3–6 vjeç, sipas fushave të zhvillimit, të arsimit parashkollor</li><li>- Mësimdhënia, të nxënësve dhe vlerësimi i bazuar në nivelet e arritjes. Raportimi i progresit dhe i arritjeve të nxënësve. Të nxënësve socio-emocional</li><li>- Planifikimi i kurrikulës dhe i veprimtarive praktike në përputhje me nevojat e nxënësve, përfshirë nxënësit me nevoja të veçanta.</li><li>- Programet për Vlerësimet Ndërkombëtare të Nxënësve (PISA; PIRLS;TIMS).</li><li>- Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare në diasporë.</li></ul>
<b>Fusha: EKGJ (Etika, Komunikimi dhe Gjithëpërfshirja)</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>- Shërbimi psiko-social dhe oficerët e sigurisë në mbështetjen e mirëqenies së nxënësve.</li></ul>

- Roli dhe funksionet e mësuesit ndihmës në arsimin gjithëpërfshirës, funksionimi i qendrave burimore sipas VKM-së përkatëse për institucionet e arsimit special.
- Aftësitë e buta, menaxhimi i klasës dhe i konflikteve, etika profesionale dhe zhvillimi i aftësive për analizën profesionale të praktikave të mësimdhënies.
- Gjithëpërfshirja, barazia dhe mosdiskriminimi në arsim.

**Fusha: ÇN (Çështje Ndërkurrikulare)**

- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Edukimi për menaxhimin e emergjencave.
- Edukimi për shëndetin.
- Promovimi i identitetit kombëtar dhe i diversitetit kulturor.
- Parandalimi i diskriminimit, bullizmit dhe përjashtimit social.
- Edukimi për median dhe informacionin.
- Qytetaria digjitale dhe siguria në internet.
- Bashkëpunimi me komunitetin.

**Fusha: DRSC (Drejtimi dhe sigurimi i cilësisë)**

- Formimi dhe zhvillimi i vazhduar i drejtuesve të institucioneve arsimore parauniversitare.
- Drejtuesit e rrjeteve profesionale, koordinatorët e sigurimit të cilësisë, koordinatorët e orientimit për karrierë të nxënësve.
- Trajnerë dhe specialistë të vlerësimit në funksion të zbatimit të risive kurrikulare. Vetvlerësimi i institucioneve arsimore.
- Standardet profesionale të mësuesit dhe të drejtuesit të institucionit arsimor.
- Roli i mentorit dhe zhvillimi i praktikave profesionale në kuadër të profesionit të rregulluar të mësuesit.

**Fusha: TIK (Aftësimi digjital dhe integrimi i teknologjisë në procesin mësimor)**

- Përdorimi i SmartLab-eve në teknologji, aftësi digjitale dhe inteligjencë artificiale.
- Përdorimi i TIK-ut, IA, platformave interaktive në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve.
- Përdorimi praktik i laboratorëve virtualë në procesin mësimor.
- Përdorimi i micro:bit për zhvillimin e mendimit kritik dhe të zgjidhjes së problemeve.
- Siguria kibernetike.

### SHTOJCA 3

#### FORMATI I APLIKIMIT PËR AKREDITIMIN AKTIVITETEVE TË ZHVP-SË

<i>Dokumentet e dorëzuara</i>	<i>Të dhënat</i>
Të dhënat e ofruesit të aktiviteteve të ZHVP-së	Emri i ofruesit
	Emri i administratorit
	Adresa e postës elektronike
	Adresa postare
	Numri i tel/cel
	Linku zyrtar
Dokumentacioni juridik	Ekstrakt nga QKB
	Vendim gjykatë
	VKM
	NIPT
	Statut
Personi kontakti	Emri dhe mbiemri
	Adresa e postës elektronike
	Numri i tel/cel
Aktiviteti i ofruesit (veprimtaritë kyç, bashkëpunimet, numri i punonjësve etj.)	
Lloji i aktivitetit të ZHVP-së: Trajnime.	
Forma e ofrimit të trajnimeve: (i drejtpërdrejtë/ i kombinuar/ online)	
Përfituesit e trajnimeve:	
Përshkrimi i rëndësishëm së trajnimeve për tematikat përkatëse dhe ndikimi që do të ketë në procesin mësimor (jo më shumë se 100 fjalë):	

Çështjet kryesore që do të trajtohen gjatë trajnimeve (jo më shumë se 200 fjalë):	
Përshkrimi i metodave të organizimit të aktiviteteve trajnuese (jo më shumë se 100 fjalë):	
Përshkrimi i mjeteve që përdoren gjatë trajnimeve (jo më shumë se 100 fjalë):	
Forma e vlerësimit të përfituesve gjatë trajnimeve:	
Bashkëpunimet me organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit:	
Përshkrimi i përmbledhur i ekspertizës dhe i aftësive të secilit trajner (Bio deri 100 fjalë): Bashkëlidhur CV-të për çdo trajner të aktivitetit sipas modelit EUROPASS (deri në 5 faqe A4).	
Emri i trajnerit ....	(Bio deri 100 fjalë)
.....	.....

## SHTOJCA 4

### LISTA PËRMBLEDHËSE E MODULEVE TË TRAJNIMIT

Emri i ofruesit të aktivitetit trajnues:								
Nr	Titulli i modulit	Forma e ofrimit të aktivitetit: (i drejtpërdrejtë/ i kombinuar ose online.)	Emrat e trajnerit/ëve	Numri i seancave të modulit të trajnimit	Emërtimi i seancave të modulit të trajnimit	Numri i orëve të modulit të trajnimit	Numri i ditëve të modulit të trajnimit	Tarifa e trajnimit (Nëse ka)
1.								
2.								
3.								
4.								
5.								
6.								
7.								
8.								
9.								
10.								

## SHTOJCA 5

### FORMATI I APLIKIMIT PËR NJË MODUL TRAJNIMI/ MIKRO – KREDENCIAL

1. Forma e trajnimit/mikro-kredencialit:
2. Tema e modulit të trajnimit/ mikro-kredencialit:
3. Numri i orëve të modulit të trajnimit/ mikro-kredencialit:
4. Numri i seanceve
5. Tema e çdo seance:
6. Përfituesit nga zhvillimi i modulit të trajnimit/ mikro-kredencialit:
7. Rezultatet e pritshme:
8. Përshkrimi i detajuar përmbajtjes:
9. Metodologjia:
  - a) Metodatat e detajuara që do të përdoren gjatë çdo seance të trajnimit:
  - b) Mjetet mësimore:
  - c) Detyra për të trajnuarit:
10. Literatura e rekomanduar për të trajnuarit:
11. Mënyra e vlerësimit të pjesëmarrësve dhe instrumenti përkatës i vlerësi

#### Kritere dhe udhëzime për plotësimin e shtojcës 5, formatit të aplikimit për modul trajnimi/ mikro -kredencial

1. Forma e trajnimit:

Në tabelë shënoni me “V” formën e trajnimit.

Trajnim i drejtpërdrejtë	
Trajnimi i kombinuar	
Trajnimi online	

2. Tema e modulit të trajnimit:
3. Numri i orëve të modulit të trajnimit:
4. Numri i seanceve
5. Tema e çdo seance:
6. Përfituesit nga zhvillimi i modulit të trajnimit:

Përfituesit e mundshëm nga trajnimi janë:

#### Drejtori i institucionit arsimor

- Tregoni nivelin e institucionit arsimor (arsimi parashkollor, arsimi fillor, arsimi i mesëm i ulët, arsimi bazë, arsimi i mesëm i lartë)
- Kur është drejtor i arsimit të mesëm të lartë, specifikoni nëse është gjimnaz, arsim profesional apo arsim i mesëm i orientuar.

## Mësuesi

- Përcaktoni nivelin e tij arsimor. Për arsimin e mesëm, tregoni lëndën.
- Nëse për arsimin fillor, tematika e trajnimit ka të bëjë me një fushë të nxëni/ lëndë, tregojeni atë.

Etj.

### 7. Rezultatet e pritshme:

- Përshkruani se çfarë duhet të jenë në gjendje të dinë dhe të bëjnë të trajnuarit në përfundim të modulit (kompetencat e tyre profesionale).
- Çdo rezultat duhet të jetë i matshëm dhe i arritshëm.
- Një rezultat paraqitet me një frazë.

### 8. Përshkrimi i përmbajtjes:

Përmbajtja e modulit përshkruhet e detajuar për çdo seancë trajnimi. Ju do t'i përgjigjeni pyetjes “Çfarë përmban moduli?”, duke përfshirë rëndësinë dhe impaktin që ka ky modul në sistemin arsimor. *Çfarë çështjesh do të trajtojë ky modul, referuar tematikave të seancave?* etj.

Përshkrimi të jetë jo më shumë se 4 faqe A4, e shkruar në kompjuter me Times New Roman.

### 9. Metodologjia:

Te metodologjia përshkruhen format dhe veprimtaritë, me të cilat trajneri do të zhvillojë përmbajtjen dhe se si pjesëmarrësit në trajnim do të arrijnë rezultatet e pritshme.

Metodologjia përmban këto elemente:

#### a) Metodatat gjatë trajnimit:

##### Për trajnimin e drejtpërdrejtë

Përshkrimi i metodave gjatë trajnimit për çdo seancë trajnimi, si: leksioni, demonstrimi, debati, diskutimi, eksperimenti, simulimi, puna e pavarur individuale, puna në grupe të vogla, puna me të gjithë pjesëmarrësit, loja me role, vizita studimore, biseda me të ftuar, përdorimi i platformave interaktive, përdorimi i teknologjisë etj.

##### Për trajnimin e kombinuar

Konsultim nëpërmjet takimeve me të trajnuarit ose/dhe nëpërmjet internetit. Përshkrim i konkretizuar i metodave mbizotëruese në të dyja format e konsultimeve.

##### Për trajnimin online të ketë platformë ndërvepruese.

#### b) Përshkrimi i konkretizuar i mjeteve mësimore:

- Pamore (fotografi, piktura, diafilma, diapozitivë, flipçart, grafikë, diagrame etj.)
- Auditive

- Audiovizuale (filmi, televizioni, videoja etj.)
  - Etj.
- c) Detyra për të trajnuarit, për t'i realizuar gjatë ose/dhe pas modulit, janë punë individuale ose në grup për përgatitje të detyrave tematike, rasteve studimore, projekteve, eseve etj.
10. Literatura e rekomanduar për të trajnuarit për t'u shfrytëzuar gjatë dhe pas modulit.  
Literatura përmban jo vetëm titujt e librave ose të shkrimeve por edhe ekstrakte të tyre, numrin e faqeve dhe cilat faqe duhet të studiojë i trajnuari.
11. Mënyra e vlerësimit të pjesëmarrësve dhe instrumenti përkatës i vlerësimit:  
Në këtë rubrikë përshkruhet mënyra e vlerësimit të pjesëmarrësit për të vlerësuar arritjen e rezultateve të pritshme. Gjithashtu në këtë rubrikë vendoset edhe instrumenti i vlerësimit p.sh., një test model për vlerësimit e modulit bashkë me përgjigjen e kërkesave dhe pikëzimin përkatës.  
Një test, i cili parashikohet të zhvillohet nga i trajnuari për rreth 40 - 60 minuta dhe synon të verifikojë përmbushjen e rezultateve të pritshme. Në testin model shënohet dhe kohëzgjatja e tij.